


9-10 DECEMBER 2026  
TIRANA



3RD INTERNATIONAL CONFERENCE  
OF THE CENTRE FOR ART STUDIES

# PERFORMING FREEDOM ON POST-GLOBALIST STAGES

## Call for Papers

In 2025, the sociologist Victor Roudometof attempted to reconsider the theoretical lenses and flexibility surrounding the use of “globalization” as a concept, contributing to discussions about the sense of an emerging post-globalization era, a notion increasingly articulated since COVID-19 and the latest wars and crises. He clearly distinguishes between the economic and political dimensions of the concept and the socio-cultural understanding of “globalism.” From this perspective, a post-“globalization” era is primarily understood as a policy regime closely associated with economic neoliberalism. However, as Roudometof notes, globalization itself can be defined in multiple ways: “For example, Sterns [2010] considers connectivity, not institutional factors, as the key indicator of globalization; and that leads him, just like Sachs [2020], into antiquity and even the prehistoric eras. In contrast, Osterhammel and Petersson [2009] suggest that globalization’s emergence is tantamount to the post-sixteenth-century breakthroughs of Western European modernity.” As the theatre scholar Petar Denchev observes, “post-globalization”, should not be understood as an end, but rather as a mutation.

Driven by anti-colonial liberation movements, imperial expansion, and the demand for cheaper resources during the era of technological revolution, the modern world witnessed the forceful historical emergence of nation-states. Initially presented as instruments of development, they later became instruments of globalization. Despite efforts to establish clear lines of national identity through language and culture, national arts continuously borrowed, exchanged, and adapted ideas, styles, and schools, creating local particularities within a broader global framework while remaining internationally intelligible and embraced by diverse audiences. The performing arts played an active role in the construction of the modern nation-state, contributing to the standardization of language and culture and to the canonization of national myths. The “national stage” was therefore not merely a metaphor, but a concrete cultural mechanism that helped produce civic reflexes and cultivate a sense of national belonging among its audiences.

Just as the world once feared the technological revolution and its consequences, today it fears the new digital revolution, which has revived similarly harsh imperialistic tones in new forms. As borders seek to rise higher and the language of sovereignty, protection, and tradition re-emerges with renewed force, global connectivity is not disappearing; rather, it is





becoming selective, strategic, and increasingly shaped by new power relations. What we are witnessing today is not the disappearance of the nation, but its reformulation under new historical pressures. The performing arts are not external to this process. On the contrary, they constitute some of its most visible laboratories.

Post-globalization culture, or what might also be described as an Artificial Intelligence culture, is more intensely internationalized than ever before. Contemporary systems of national arts funding often function as mechanisms through which culture is prevented from fully addressing the rational and emotional dimensions of the exploitation of the Earth, including the exploitation of human beings and genocide. Questions of state sovereignty should therefore be discussed alongside issues of food sovereignty, informational sovereignty, knowledge sovereignty, and privacy sovereignty within this new surveillance-oriented post-globalized world. Digital platforms expand access while simultaneously governing visibility through algorithmic structures. Audiences are no longer simply national or global; they are infrastructurally constructed. In such an environment, sovereignty no longer exists as a fixed territorial condition, but as a performative process: it is staged, branded, and mediated. Festivals increasingly function as diplomatic stages, while cultural production operates as a form of soft power. Yet the same structures that promise dialogue and connectivity can also produce conformity. Networks of solidarity frequently become networks of insecurity and precarity. Artistic careers continue to attract individuals drawn to freedom, expression, and recognition, even while remaining fully aware that they may also face precarity, censorship, and, at worst, irrelevance. Each artist ultimately chooses how to negotiate this tension.

On the first day, the conference will address the historical relationship between the arts and the formation of nation-states. It will examine how artistic production has both shaped and been shaped by nation-state paradigms. On the second day, the focus will shift to the present, exploring contemporary global challenges and examining how theatre and music function as spaces of critical reflection, human empathy, and transnational dialogue.

Suggested topics include but are not limited to:

- The state's use of the stage to perform sovereignty
- Funding regimes and the constraints imposed on aesthetic risk
- Festivals as spaces of dialogue or as mechanisms for managing dissent
- Digital mediation and the transformation of audiences into measurable activity
- Art as resistance to isolationism, populism, and cultural control
- Who remains invisible in these processes?
- How are engaged artists today confronting the re-emergence of ideologically failed promises regarding the abolition of intrusive state power in the name of freedom?
- Is there sufficient space for freedom to confront and resist imperial ambitions?
- Performing arts and the historical formation of national identity
- Theatre and music as tools of myth-making, canon formation, and cultural cohesion





- Migration, diaspora, and transnational artistic collaboration
- Excluded performance arts oppressed by national cultures as consequence of the centrality of globalization concepts.

We welcome proposals from scholars, researchers, artists, curators, and cultural practitioners across disciplines, including theatre and performance studies, dance, musicology, cultural studies, political theory, media and related fields. Early-career researchers are also welcomed.

**Organized by:**

Dr. Anxhela Çikopano & Centre for Art Studies / Academy of Sciences of Albania

**Scientific Committee [Alphabetical Order]:**

Dr. Anxhela Çikopano - Centre for Art Studies / Academy of Sciences of Albania

Assis. Prof. Petar Dentchev, PhD - Institute of Art Studies / Bulgarian Academy of Sciences

Prof. António Dores - University Institute of Lisbon (ISCTE-IUL).

Dr. Kreshnik Duqi - Centre for Art Studies / Academy of Sciences of Albania

Asoc. Prof. Dr. Majlinda Hala - University of Arts, Tirana

Prof. Dr. Hab. Violetta Kostka - Academy of Music in Gdańsk

Prof. Daniel Nordgård - University of Agder

Dr. Francesco Scasciamacchia - Polis University, Tirana

Acad. Vasil S. Tole - Academy of Sciences of Albania

Dr. Gašper Troha - Slovenian Theatre Institute / Academy of Theatre, Radio, Film, and Television, University of Ljubljana.

**Keynote Speakers [Alphabetical Order]:**

Prof. Keith Negus - University of Agder

Prof. Nicholas Ridout - Queen Mary University of London

Asoc. Prof. Nicholas Tochka - University of Melbourne

Dr. Luan Topçiu - Coordinator of the Cultural Center of the Albanians of Romania / University of Bucharest

**Coordinators:**

Dr. Kreshnik Duqi

Amela Manushi

Durim Taçi

Enza Rripaj

**Submission Guidelines**

- Abstracts should be 250–300 words, with keywords
- Name, surname, affiliation, email address, mobile number
- Please include a short biographical note [100 words]
- Language of submission: English and/or Albanian






- Submission deadline: 10 July 2026
- Notification of acceptance: 30 July 2026

Please send abstracts and biographical notes to:  
[infostudimiarteve@akad.gov.al](mailto:infostudimiarteve@akad.gov.al) & [anxhela.cikopano@akad.gov.al](mailto:anxhela.cikopano@akad.gov.al)  
For any further information, please contact:  
[anxhela.cikopano@akad.gov.al](mailto:anxhela.cikopano@akad.gov.al)



9-10 DHJETOR 2026  
TIRANË



KONFERENCA III NDËRKOMBËTARE  
E QENDRËS SË STUDIMIT TË ARTEVE

# INTERPRETIMI I LIRISË NË SKENAT E POST-GLOBALIZMIT

## Thirrje për punime

Në vitin 2025, sociologu Viktor Rudometof [Victor Roudometof] mori edhe një herë në shqyrtim qasjet teorike dhe fleksibilitetin e konceptit “globalizëm”, duke kontribuar në debatin mbi ndjesinë e lindjes së epokës post-globaliste, një nocion i artikuluar gjithmonë e më shpesh pas epidemisë së COVID-19, luftërave dhe krizave të kohëve të fundit. Ai sjell një dallim të qartë mes dimensionit ekonomik e politik të konceptit “globalizëm” dhe kuptimit të tij shoqëror e kulturor. Nga kjo perspektivë, një epokë “post-globaliste” kuptohet kryesisht si një regjim politikash, i lidhur ngushtë me neoliberalizmin ekonomik. Megjithatë, siç vëren Rudometofi, vetë globalizimi mund të përkufizohet në mënyra të ndryshme: “Për shembull, Stërnsi [Sterns, 2010] merr në konsideratë si tregues kryesor të globalizimit ndërlidhjen e ndërveprimin e jo faktorët institucionalë, qëndrim që e çon atë, sikurse edhe Sahsinin [Sachs, 2020] drejt antikitetit, madje deri në periudhat parahistorike. Në të kundërt, Osterhameli dhe Petërsoni [Osterhammel, Petersson, 2009] sugjerojnë se shfaqja e globalizimit është e barasvlershme me përparimin e modernitetin në Evropën Perëndimore pas shekullit të gjashtëmbëdhjetë.” Por, siç vëren studiuesi i teatrit Petar Dençev [Petar Denchev], “post-globalizimi” nuk duhet kuptuar asses si një fund, se sa si një mutacion.

Nxitur nga lëvizjet çlirimtare antikoloniale, zgjerimet imperialiste dhe kërkesa për burime me kosto sa më të ulët, gjatë epokës së revolucionit industrial, bota moderne u bë dëshmitare e lindjes së fuqishme të shteteve-kombe. Fillimisht të paraqitura si instrumente zhvillimi, ato më vonë do të ktheheshin në mjete të globalizimit. Pavarësisht përpjekjeve për të vendosur kufij të qartë të identitetit kombëtar përmes gjuhës dhe kulturës, artet kombëtare vazhduan të huazonin, të shkëmbejnë dhe të përshtatnin ide, stile dhe shkolla artistike, duke krijuar veçori lokale brenda një kuadri më të gjerë global, ndërkohë që mbeteshin ndërkombëtarisht të qarta dhe të mirëpritura nga audienca të ndryshme. Artet skenike luajtën rol aktiv në ndërtimin e shtetit-komb modern, duke kontribuar në standardizimin e gjuhës dhe të kulturës, si dhe në kanonizimin e miteve kombëtare. Për rrjedhojë, “skena kombëtare” nuk ishte thjesht një metaforë, por një mekanizëm kulturor konkret, që ndihmoi në formimin e reflekseve qytetare dhe në kultivimin e ndjenjës së përkatësisë kombëtare tek audienca e saj.

Ashtu si bota dikur i druhej revolucionit teknologjik dhe pasojave që do të buronin prej tij, sot ajo i druhet revolucionit të ri digjital, i cili ka rikthyer në forma të reja tone po aq të ashpra imperialiste. Ndërsa kufijtë kanë prirje të ngrihen edhe më lart dhe gjuha e sovranitetit,





e mbrojtjes dhe e traditës rishfaqet me forcë të përtërirë, ndërlidhja globale nuk po zhduket, përkundrazi, ajo po bëhet më përzgjedhëse, më strategjike dhe po merr gjithmonë e shumë formë nga marrëdhënie të reja pushteti. Ajo që shohim sot nuk është zhdukja e shtetit-komb, por riformulimi i tij nën trysni të reja historike. Artet skenike nuk mbeten jashtë këtij procesi. Përkundrazi, ato janë disa prej laboratorëve më të dukshëm të tij.

Kultura e post-globalizimit, që përkon edhe me kulturën e Inteligjencës Artificiale, sot është më e ndërkombëtarizuar se kurrë më parë. Sistemet bashkëkohore të financimit shtetëror të arteve kombëtare shpesh funksionojnë si mekanizma, përmes të cilëve kultura pengohet të trajtojë plotësisht dimensionin arsyetues dhe emocional mbi shfrytëzimin e Tokës, ku përfshihet edhe shfrytëzimi i qenieve njerëzore apo gjenocidi. Prandaj, çështjet e sovranitetit shtetëror duhet të diskutohen paralelisht me ato të sovranitetit ushqimor, informativ, të dijes dhe të privatësisë në këtë botë të re post-globaliste, të orientuar gjithnjë e më shumë drejt mbikëqyrjes. Platformat digjitale e zgjerojnë qasjen, por njëkohësisht kontrollojnë shikueshmërinë përmes strukturave algoritmike. Audiencat nuk janë më thjesht kombëtare ose globale, ato ndërtohen nëpërmjet infrastrukturave teknologjike. Në një mjedis të tillë, sovraniteti nuk ekziston më si një gjendje e pandryshueshme territoriale, por si një proces interpretimi: ai ngjitet në skenë, i vihet një markë dhe negociohet mbi të ose përmes tij. Festalet po funksionojnë gjithmonë e më shumë si skena diplomatike, ndërsa prodhimi kulturor vepron si një formë e butë pushteti. Ndërkohë, të njëjtat struktura që premtojnë dialog dhe ndërlidhje mund të kthehen në struktura që prodhojnë konformizëm. Rrjetet e solidaritetit shndërrohen shpesh në rrjete pasigurie dhe dobësie ekonomike e profesionale. Karrierat artistike vazhdojnë të tërheqin individë që shtyhen nga dëshira për liri, shprehje të vetvetes dhe njohje publike, edhe kur këta janë plotësisht të vetëdijshëm se mund të përballen me pasiguri, censurë dhe, në rastin më të keq, me mospërfillje. Në fund, secili artist e zgjedh vetë mënyrën se si duhet të negociojë me këto tensione.

Në ditën e parë, konferenca do të trajtojë marrëdhënien historike midis arteve skenike dhe formimit të shteteve-kombe. Ajo do të shqyrtojë mënyrat se si prodhimi artistik ka ndikuar dhe është ndikuar nga paradigmat e shtetit-komb. Në ditën e dytë, fokusi do të zhvendoset tek e tashmja, për të eksploruar sfidat bashkëkohore globale dhe për të analizuar se si teatri dhe muzika funksionojnë si hapësira reflektimi kritik, të empatisë njerëzore dhe të dialogut mes kombeve.

Temat e sugjeruara, përfshijnë, po nuk kufizohen në:

- Përdorimi i skenës nga shteti për të interpretuar sovranitetin;
- Regjimet e financimit dhe kufizimet që imponohen mbi estetikën;
- Festalet si hapësira dialogu ose si mekanizma për menaxhimin e mospajtimit;
- Ndërmjetësimi digjital dhe shndërrimi i audiencave në ndërveprim të matshëm;
- Arti si formë rezistence ndaj izolimit, populizmit dhe kontrollit kulturor;
- Kush mbetet i padukshëm në gjithë këto procese?
- Si po përballen artistët e angazhuar me rishfaqjen e premtimeve ideologjike të dështuara për mosndërhyrjen e shtetit dhe ruajtjen e lirisë?





- A ekziston hapësirë e mjaftueshme që liria të përballlet dhe t'u rezistojë ambicieve imperialiste?
- Artet e interpretuara [skenike] dhe formimi historik i identitetit kombëtar;
- Teatri dhe muzika si mjete të krijimit të miteve, të formimit të kanoneve dhe të kohezionit kulturor;
- Migracioni, diaspora dhe bashkëpunimi artistik mes kombeve;
- Artet e përjashtuara ose të shtypura skenike prej kulturave kombëtare, si pasojë e vënies në qendër të koncepteve të globalizimit.

Mirëpritën propozime nga studiues, kërkues shkencorë, artistë, kuratorë dhe profesionistë të kulturës nga disiplina të ndryshme, përfshirë studimet teatrore dhe të interpretimit, kërcimit, muzikologjisë, studimet kulturore, teoritë politike dhe fusha të tjera të përafërta. Mirëpritën edhe studiues të rinj.

### **Organizuar nga:**

Dr. Anxhela Çikopano për Qendrën e Studimeve të Arteve / Akademia e Shkencave e Shqipërisë

### **Komiteti shkencor [në rend alfabetik]:**

Dr. Anxhela Çikopano – Qendra e Studimeve të Arteve / Akademia e Shkencave e Shqipërisë  
Assis. Prof. Petar Dentchev, PhD – Instituti i Studimeve të Artit / Akademia Bullgare e Shkencave

Prof. António Dores – Instituti Universitar i Lisbonës [ISCTE-IUL]

Dr. Kreshnik Duqi – Qendra e Studimeve të Artit / Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Asoc. Prof. Dr. Majlinda Hala – Universiteti i Arteve, Tiranë

Prof. Dr. Hab. Violetta Kostka – Akademia e Muzikës në Gdańsk

Prof. Daniel Nordgård – Universiteti i Agderit

Dr. Francesco Scasciamacchia – Universiteti Polis, Tiranë

Akad. Vasil S. Tole – Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Dr. Gašper Troha – Instituti Slloven i Teatrit / Akademia e Teatrit, Radios, Filmit dhe Televizionit, Universiteti i Lubjanës

### **Folësit kryesorë [në rend alfabetik]:**

Prof. Keith Negus – Universiteti i Agderit

Prof. Nicholas Ridout – Universiteti Queen Mary i Londrës

Asoc. Prof. Nicholas Tochka – Universiteti i Melburnit

Dr. Luan Topçiu – Koordinator i Qendrës Kulturore të Shqiptarëve të Rumanisë / Universiteti i Bukureshtit

### **Koordinatorë:**

Dr. Kreshnik Duqi

Amela Manushi

Durim Taçi

Enza Rripaj



**Udhëzime për abstraktet:**

- Abstraktet duhet të jenë 250–300 fjalë dhe të shoqërohen me fjalë kyçe;
- Emri, mbiemri, institucioni dhe adresa e emailit
- Ju lutemi, përfshini edhe një biografi të shkurtër (100 fjalë);
- Gjuha e dorëzimit: anglisht dhe/ose shqip;
- Afati i dorëzimit: 10 korrik 2026;
- Njoftimi i pranimit: 30 korrik 2026.

Ju lutemi, dërgojini abstraktet dhe biografitë në adresat:

[infostudimiarteve@akad.gov.al](mailto:infostudimiarteve@akad.gov.al) & [anxhela.cikopano@akad.gov.al](mailto:anxhela.cikopano@akad.gov.al)

Për çdo informacion tjetër, ju lutemi kontaktoni:

[anxhela.cikopano@akad.gov.al](mailto:anxhela.cikopano@akad.gov.al)

